



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 02.08.2024

Nr: 167

Ora: 13:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 1 ID NGA KOALICIONI
“BASHKË FITOJMË”, NDAJ PERSONAVE PËRGJEGJËS PËR SHKELJE
ADMINISTRATIVE, PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË
BASHKISË HIMARË TË DATËS 4 GUSHT 2024”**

Sot më datë 02.08.2024, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim çështjen administrative me:

KËRKUES: Koalicioni Bashkë Fitojmë

SUBJEKT: Z. Zambak Selmani, Drejtor i Infrastrukturës në bashkinë Vlorë;
Z. Dorian Demiri, Drejtor Juridik në bashkinë Vlorë;
Z. Meçan Myrtaj, Drejtor i IMT, Himarë;
Z. Admir Malaj, Drejtor i DRSHTRR, Vlorë;
Z. Ermal Dredha, Kryetar i Bashkisë Vlorë.

OBJEKT: Shqyrtim administrativ për shkelje administrative në kundërshtim me Kodin Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020.

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe pika 2, neneve 91, pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

Data: 02.08.2024

Nr: 167
Ora: 13:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 1 ID nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, ndaj personave përgjegjës për shkelje administrative, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024”

KONSTATOJ:

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është administruar denoncimi me shkresën nr. 2197 më datë 26.07.2024 nga subjektit zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”. Nëpërmjet këtij denoncimi të regjistruar nga KQZ me nr. 1 ID, pretendohet si më poshtë vijon:

“Koalicioni “Bashkë Fitojmë” paraqet kërkesën si vijon në mbrojtje të interesave të saj në këto zgjedhje, pasi vlerësojmë se po cenohemi në të drejtat tona për zhvillimin e një gare të ndershme, të lirë dhe të barabartë në Bashkinë e Himarës.

Kodi Zgjedhor në Nenin 123/1 “E drejta për të vënë në lëvizje KQZ-në” parashikon se:

“1. KQZ-ja vihet në lëvizje kryesisht, me kërkesë të subjekteve zgjedhore, në zbatim të të drejtave që u njeh ky ligj, si dhe me kërkesë të palëve të treta, në mbrojtje të interesave të tyre të ligjshme dhe për çështje që bëjnë pjesë në rrethin e kompetencave të KQZ-së.

2. Kërkesat ose ankesat e subjekteve zgjedhore trajtohen sipas procedurës së përcaktuar nga ky ligj dhe nga aktet nënligjore të dala në zbatim të tij’. Kërkesat, ankesat, informacionet, propozimet apo denoncimet e palëve të treta trajtohen sipas procedurës së përcaktuar në Kodin e Procedurave Administrative dhe sipas afateve që përcakton KQZ-ja me akt nënligjor. [...]”.

Kështu, nga denoncimet dhe raportimet e ardhura nga terreni, Koalicioni “Bashkë Fitojmë” ka konstatuar se në bashkinë Himarë kanë nisur shkeljet e para të rregullave më elementare të barazisë në garën elektorale, siç janë (keq)përdorimi i administratës publike dhe punonjësve të Shtetit, të cilët kanë dalë në terren bashkë me kandidatin e PS, njëherësh Prefekt i Qarkut Vlorë.

Më konkretisht, nga vetë fotografitë e postuara nga kandidati i PS Vangjel Tavo në rrjetin social “Facebook”, rezulton se administrata e Bashkisë së Vlorë është angazhuar në takimet elektorale të Prefektit të Vlorës — kandidat në Himarë. Portale të ndryshme kanë evidentuar shtetasit e mëposhtëm prezent në takimet elektorale të kandidatit të PS :

1. Zambak Selmani, drejtor i infrastrukturës në Bashkinë Vlorë;
2. Dorian Demiri, drejtor Juridik në Bashkinë Vlorë;
3. Admir Malaj, drejtor i Drshtrr Vlorë;
4. Yleçan Myrtaj, drejtor i IMT Himarë;
5. Ermal Dredha, kryetar Bashkie.

Sqarojmë se një pjesë e takimeve janë zhvilluar në orar zyrtar pune, çka bie ndesh me Kodin Zgjedhor, por edhe me legjislacionin në fuqi për statusin e nëpunësit civil, ligj i cili referuar pikës 4, si dhe në kuptim të nenit 37, të ligjit nr.152/2013, të ndryshuar, u ndalon **nëpunësve publikë**:

- a) të bëjë fushatë për një subjekt zgjedhor;
- b) të manifestoje me pankarta, parrulla apo çdo mjet fjeter të shkruar dhe të ekspozuar publikisht;
- c) të jetë protagonist në aktivitetet/veprimtaritë politike.

Bashkëngjitur po ju vendosim LINK¹ e postimit denoncues i shoqëruar edhe me fotografitë ku evidentohen personat që shoqërojnë Prefektin Kandidat në Himarë.

Në këto kushte, Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, po paraqet zyrtarisht këtë kërkesë lidhur me denoncimin e veprimeve të punonjësve të institucioneve publike që vijnë në kundërshtim me parimet demokratike dhe rregullat e parashikuara në Kodin Zgjedhor për zgjedhjet vendore të 04 Gushtit 2024 për Bashkinë Himarë, duke kërkuar përfundimisht:

1) Nisjen e hetimit administrativ për këtë rast nga administrata e KQZ ; si dhe

2) Marrjen e masave administrative përkatëse ndaj këtyre veprimeve antiligjore, sipas legjislacionit në fuqi.”

Link: <https://www.facebook.com/share/p/G2erdijPXPbcV7g/?=qi20mg>

Bazuar në sa më sipër neni 19 pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar përcakton kompetencat e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Në mbështetje të përcaktimit të nenit 8, pika 1, “a” dhe “b” të vendimit nr. 9 datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator, KSHZ filloi hetimin administrativ.

Sa më sipër Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nëpërmjet shkresës nr. 2213 prot., datë 26.07.2024 me lëndë “Kërkesë për Informacion”, i ka kërkuar bashkisë Himarë, bashkisë Vlorë, Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Vlorë /(DRSHTRR), si dhe personave të denoncuar, informacion të detajuar për sa kërkohet në denoncimet me objekt “Parregullsi zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme në bashkinë Himarë.”

Në vijim nga administrata e KQZ-së, shkresa e sipërcituar, u është dërguar palëve edhe nëpërmjet komunikimit elektronik të datës 27.7.2024, ora 11: 42 me objekt “Kërkesë për informacion”.

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve janë administruar kthimi i katër përgjigjeve si më poshtë vijon:

1. Komunikimi elektronik i datës 29.7.2024, ora 11:52, nëpërmjet të cilit z. Admir Malaj me detyrë Drejtor i DRSHTRR, bën me dije se:

“Referuar denoncimit të fotove të publikuara të punonjësve publikë Bashkia Vlorë, ku nënvizohet edhe emri im, unë Admir Malaj, si Kryetar i Partisë Socialiste Vlorë dhe Drejtor pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Vlorë (DRSHTRR), konfirmoj që jam pjesëmarrës në takimet e zhvilluara në fushatën për Bashkinë Himarë dhe fotot e publikuara përkojnë me identitetin tim. Takimet janë zhvilluar jashtë orarit zyrtar, 8:00-16:00 nga kandidati z. Vangjel Tavo, duke nisur rreth orës 17:00 dhe në vazhdim, ku shpeshherë ka pasur edhe shtyrje të orareve me qëllim mos ndërprerjen e procesit të punëve përkatëse brënda orarit zyrtar. Për verifikim, oraret e takimeve janë të shpallura edhe në faqen zyrtare të “Facebook” - ut z. Vangjel Tavo, si dhe komunikimet e përditshme në Ëhatsapp. Deri këtu unë nuk shkel asnjë të drejtë ligjore përsa i përket angazhimit tim jashtë orarit të punës.”

2. Komunikimi elektronik i datës 29.7.2024, ora 11:13 nëpërmjet të cilit z. Mekan Myrtaj, me detyrë Drejtor i IMT, Himarë na bën me dije se:

“Qnhem Meçan Myrtaj, aktualisht jam i komanduar ne pozicionin e punes Kryeinspektor i IMT Bashkia Himare, po ju shkruaj kete informacion lidhur me dononcimin e bere nga koalicioni "Bashke Fitojme" per pjesmarrjen time ne takimin elektorale te zhvilluar ne fshatin Kallarar nga kandidati i Partise Socialiste z. Vangjel Tavo per zgjedhjet e pjeshme ne Bashkine Himare.

Per sa me siper konfirmoj se kam marre pjese si degjues ne kete takim duke qene banor i asaj zone. Takimi eshte zhvilluar ne daten 24.07.2024 dite e merkure ora 18:00. Ku takim eshte zhilluar pas orarit zyrtar te punes, jo gjate orarit zyrtar te punes siç pretendon koalicioni "Bashke Fitojme". Kjo konfirmohet edhe nga faqja zyrtare ne Facebook te z. Vangjel Tavo ku eshte postuar takimi, ku eshte cituar edhe ora. Bashkengjitur po ju vendos linkun perkates. Fotografi te postimit.

3. Komunikimi elektronik i datës 29.7.2024, ora 12:21, nëpërmjet të cilit bashkia Himarë, na bën me dije se:

“Lidhur me kërkesën për te dhënat qe kerkohen ju bejme me dije se :

- 1. Punonjës publik në Bashkinë Himare është vetëm z. Meçan Myrtaj, me detyrë : Drejtues i policisë bashkiake, por momentalisht është i komanduar Kryeinspektor i IMT-se*
- 2. Personi ne foto përkon me identitetin e punonjësit publik.*
- 3. Është përcjell kërkesa dhe denoncimi tek punonjësi publik për informacionin e KQZ-së.*
- 4. Konfirmojmë qe punonjësi publik ka marr ne dijeni për denoncimin e bere.*
- 5. E-maili zyrtar i punonjësit publik: mecan.myrtaj@himara.gov.al*

4. Komunikimi elektronik i datës 31.7.2024, ora 00:06, nëpërmjet të cilit bashkia Vlorë me shkresën nr. 11906/1 prot., datë 30.07.2024, na bën me dije se:

“Në përgjigje të shkresës tuaj ,e nr. 2213, datë 26.07.2024, mbi “Kërkesës për informacion”, me anë të së cilës kërkohej të dhëna për funksionin, identitetin, adresës e postës elektronike si dhe shpjegimet me shkrim për datën dhe orën e pjesëmarrjes, ju sqarojmë si më poshtë:

- 1. Z. Dorian Demiri është drejtor i Drejtorisë Juridike.*
- 2. Z. Zambak Selmani është drejtor i Drejtorisë së Infrastrukturës dhe Investimeve Publike.*
- 3. Fotot e publikuara përkojnë me identitetin e punonjësve publikë të denoncuar*
- 4. Punonjësit kanë marrë dijeni për denoncimin.*
- 5. Adresa e e-mail për z. Dorian Demiri është dorian.demiri@yahoo.com*
- 6. Adresa e e-mail për z. Zambak Selmani është pashkal@live.it*

Bashkëlidhur me këtë e-mail, Bashkia Vlorë, ka vendosur në dispozicion fotografi në cilësinë e provës material dhe shpjegimet e z. Dorian Demiri dhe z. Zambak Selmani, si më poshtë vijon:

z. Dorian Demiri ka sqaruar se : “Fotografitë dhe veprimtaria e zhvilluar më datë 24.07.2024, ora 18:00, i përkasin një takimi të zhvilluar në fshatin Kallarar të bashkisë Himarë. Ora e ngjarjes ku tregohet se kanë qenë të pranishëm të lartëpërmendurit ka qenë jashtë orarit zyrtar. Konkretisht, referuar fotografive që ne disponojmë, referuar dhe fotografive që kanë qenë botuar në faqen e kandidatit Vangjel Tavo në rrjetin Facebook, koha e takimit ka qenë jashtë orarit zyrtar. Këtë jemi hati tjua provojmë sy për sy, duke ju ftuar që të kontrolloni fotografitë dhe në celularët tanë që tregojnë saktësisht kohën e shprehjes së fotografive. Ngjarja e treguar në

Facebook është thjeshtë takim që është plotësisht i lejuar dhe që nuk ndalohet nga asnjë ligj a normë ligjore qoftë në lidhje me një figurë sikurse është prefekti, qoftë në lidhje me individë që janë të punësuar në administratën qendrore e vendore. Në kuptim të kushtetutës dhe të ligjit, organizimet vullnetare mes njerëzve, sikurse mund të jenë edhe takimet, qoftë organizuar ose dhe rastësore, nuk ndalohen. Ashtu sic duket edhe nga Fotot 1, foto 2, foto 3 dhe foto 4 vërtetohet lehtësisht vendi ku kam qenë dhe personi me të cilin kam qenë i pranishëm. Po në kuptim të ligjit, të tilla organizime që zhvillohen jo në periudhe zgjedhore janë gjithashtu të lejuara. Referuar datës kur ka ndodhur ngjarja, 24.07.2024, ditë e mërkurë, ora 18:00, nuk ndodhemi para asnjë periudhe zgjedhore. Këtë e sqarojmë duke iu referuar vendimit nr. 3 regj, datë 12.07.2024, i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, pika 11, ku përcaktohet data e nisjes së fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme në bashkinë e Himarës është 27.07.2024. Në kuptim të Kodit Zgjedhor, për rrethanat thjesht faktike që lidhen me kohën e takimit, nuk ndodhemi para një veprimtarie zgjedhore. Pra, nëse takimi bëhet tre ditë, një javë ose qoftë dhe vetëm një ditë para kësaj date, ligjërisht nuk është zhvilluar në kohë fushate zgjedhore. Kësisoj, ankesa është e pambështetur në lidhje dhe në rrethanat faktike. Duke qenë e tillë, mund të ishte ftuar ankuesi që të paraqiste prova konkrete lidhur me faktin e pretenduar. Në këtë frymë, vetë postimi në Facebook jep qartë vendin, datën dhe orën e takimit. Të gjitha këto nuk lidhen faktikisht dhe as ligjërisht me fushatën zgjedhore. Këtë e dinë të gjithë, e ka ditur dhe postuesi në faqen Disidenti, që është e paregjistruar ndokund, që megjithatë ka zgjedhur të thotë të pavërteta, në mos shpifje. Nëse do të kishte prova konkrete, fajta në fjalë do ti kishte treguar pa vonesë, por thjesht ka vijuar me shpifje, duke përmendur persona publikë të cilët nuk kishin kryer asnjë shkelje të ligjeve shqiptare.

Deklaratë nga Dorian Demiri: Unë, Dorian Vero Demiri, Drejtor Juridik në bashkinë e Vlorës, sqaroj që më datë 24.07.2024 kam ushtruar detyrat e mia si drejtor në Institucionin e Bashkisë Vlorë, pas orarit zyrtar kam shkuar në fshatin Kallarë të bashkisë Himarë. Një pjesë e familjes simë ka prejardhjen nga ky fshat dhe aty kam ende të afërm. Sikurse mund të shihet nga fotografia që kam printuar, nga të dhënat e saj referuar aparatit celular, unë kam dalë në fotografi me të quajturin Dorian Luto Demiri, kushëriri im që jeton gjatë stinës së verës në atë fshat. Duke qenë qytetar shqiptar, me interesa të ndryshme familjare dhe profesionale sqaroj që nuk ka pasur asnjë pengesë ligjore për mua si individ, pavarësisht punësimit tim që të takoj të afërm të mij. Bashkëlidhur me deklaratën është dhe nënshkrimi i deklaruesit z. Dorian Demiri.

z. Zambak Selmani ka sqaruar se: “Fotografitë dhe veprimtaria e zhvilluar më datë 24.07.2024, ora 20:00, i përkasin një takimi të zhvilluar në fshatin Vranisht. Ora e ngjarjes ku tregohet se kanë qenë të pranishëm të lartë përmendur ka qenë jashtë orarit zyrtar. Konkretisht, referuar fotografive që ne disponojmë, referuar dhe fotografive që kanë qenë botuar në faqen e kandidatit Vangjel Tavo në rrjetin social Facebook, koha e takimit ka qenë jashtë orarit zyrtar. Këtë jemi gati t’ju provojmë duke ju ftuar që të kontrolloni fotografitë dhe në celularët tanë që tregojnë saktësisht kohën e shprehjes së fotografive. Ngjarja e treguar në Facebook është thjesht takim që është plotësisht i lejuar dhe që nuk ndalohet nga asnjë ligj a normë ligjore qoftë në lidhje me një figurë sikurse është prefekti, qoftë në lidhje me individë që janë të punësuar në administratën qendrore e vendore. Në kuptim të kushtetutës dhe të ligjit, organizimet vullnetare mes njerëzve, sikurse mund të jenë edhe takimet, qoftë të organizuara ose dhe rastësore, nuk ndalohen.

Po në kuptim të ligjit, të tilla organizime që zhvillohen jo në periudha zgjedhjesh janë gjithashtu të lejuara. Referuar datës kur ka ndodhur ngjarja, 24.07.2024, ditë e mërkurë, ora 20:00, nuk ndodhemi para asnjë periudhe zgjedhore. Këtë e sqarojmë duke iu referuar vendimit nr. 3 regj, datë 12.07.2024, i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, pika 11, ku përcaktohet që data e nisjes së

fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme në bashkinë e Himarës është 27.07.2024. Në kuptim të Kodit Zgjedhor, për rrethanat thjesht faktike që lidhen me kohën e takimit, nuk ndodhemi para një veprimtarie zgjedhore. Pra, nëse takimi bëhet tre ditë, një javë ose qoftë dhe vetë, një ditë para kësaj datë, ligjërisht nuk është zhvilluar në kohë fushate zgjedhore. Kësisoj, ankesa është e pambështetur në ligj dhe në rrethana faktike. Duke qenë e tillë, mund të ishte ftuar ankuesi që të paraqiste prova konkrete lidhur me faktin e pretenduar. Në këtë frymë, vetë postimi në Facebook jep qartë vendin, datën dhe orën e takimit. Të gjitha këto nuk lidhen faktikisht dhe as ligjërisht me fushatën zgjedhore. Këtë e dinë të gjithë, e ka ditur dhe postuesi në faqen Disidenti, që është e paregjistruar ndokund, që megjithatë ka zgjedhur të thotë të pavërteta, në mos shpifje. Nëse do të kishte prova konkrete, faqja në fjalë do ti kishte treguar pa vonesë, por thjesht ka vijuar me shpifje, duke përmendur persona publikë të cilët nuk kishin kryer shkelje të ligjeve shqiptare.

Deklaratë nga z. Zambak Selmani: Unë, Zambak Irakli Selmani, Drejtor Infrastruktura në bashkinë e Vlorës, sqaroj që më datë 24.07.2024 kam ushtruar detyrat e mia si drejtor në institucionin e Bashkisë Vlorë, pas orarit zyrtar kam shkuar në fshatin Vranisht. Bashkëshortja ime Erjana Bektash Bashaj ka prejardhjen nga ky fshat dhe aty ka prindërit e saj. Nuk ka pasur asnjë pengesë ligjore për mua si individ, pavarësisht punësimit tim që të takoj të afërmit e mij. Kam qenë në lokalitë e fshatit me vjehrrin tim takimi ka qenë në orën 20:00 në darkë. Nuk kam asnjë lloji interesi me bashkinë Himarë dhe asnjë familjar timin. Nuk kam asnjë të afërm që jeton ose voton në Bashkinë Himarë.” . Bashkëlidhur me deklaratën është dhe nënshkrimi i deklaruesit z. Zambak Selmani.

Bashkëlidhur përgjigjeve janë administruar në cilësinë e provës foto nga veprimtaria publike.

Në referim të nenit 91, pika 2 e Kodit Zgjedhor: “Me përdorim të “burimeve njerëzore” kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor para universitar në fushatë zgjedhore.”

Gjithashtu referuar vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator, neni 6, pika 3 parashikohet se: “Punonjësit e administratës shtetërore gjatë orarit të punës dhe brenda mjediseve të institucioneve shtetërore, i ndalohet çdolloj pjesëmarrje në veprimtarinë me karakter politik apo në funksion të politikës partiake/kandidatëve, apo në fushatë zgjedhore të ndonjë subjekti zgjedhor ose kandidati në zgjedhje.”

Në vijim, bazuar në faktet dhe provat rezultojnë se aktiviteti është publikuar në rrjetin social Facebook të kandidatit për kryetar në Bashkinë Himarë, më datë 22.07.2024 sikurse pretendohet nga denoncuesi.

Nga deklarimi i denoncuesit dhe prapsimet e të denoncuarve, vërtetohet se jemi përpara një veprimtarie me natyrë zgjedhore të kandidatit për kryetar të bashkisë Himarë, z Vangjel Tavo. Personat e denoncuar, pohojnë se kanë marrë pjesë në takimet elektorale të kandidatit Vangjel Tavo pas orarit zyrtar.

Pasi u njoha me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerësoj se veprimtaria publike është zhvilluar jashtë afatit të fushatës zgjedhore të përcaktuara në vendimin nr. 3, datë 12.07.2024, të Kolegjit Zgjedhor. Sipas këtij vendimi periudha e fushatës zgjedhore për zgjedhjet për kryetar të bashkisë Himarë të datës 4 Gusht 2024, është data 27.07.2024.

Gjithashtu nuk jemi në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në nenin 91 të Kodit Zgjedhor apo edhe sipas të nenit 3 të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator për sa lidhet me keqpërdorimin e burimeve publike.

Sipas nenit 91 të Kodit Zgjedhor, pika 1 dhe 2 e tij, kompetenca e KQZ për të vlerësuar sjelljen e nëpunësve të administratës publike, apo edhe funksionarëve të tjerë të tillë, shtrihet vetëm përgjatë fushatës zgjedhore. Jashtë kësaj periudhe kohore, KQZ nuk ka kompetencën të shqyrtojë dhe të vlerësojë ligjshmërinë e veprimeve të subjekteve të mësipërm.

Sa më sipër vlerësoj se duhet të pushohet hetimi administrativ për z. Zambak Selmani, Drejtor i Infrastrukturës në bashkinë Vlorë, z. Dorian Demiri, Drejtor Juridik në bashkinë Vlorë, z. Meçan Myrtaj, Drejtor i IMT Himarë dhe z. Admir Malaj, Drejtor i DRSHTRR, Vlorë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve,

V E N D O S:

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj:
 - Z. Zambak Selmani, Drejtor i Infrastrukturës në bashkinë Vlorë;
 - Z. Dorian Demiri, Drejtor Juridik në bashkinë Vlorë;
 - Z. Meçan Myrtaj, Drejtor i IMT, Himarë;
 - Z. Admir Malaj, Drejtor i DRSHTRR, Vlorë;
 - Z. Ermal Dredha, Kryetar i Bashkisë Vlorë.
2. Moskonstatimin e shkeljes administrative.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palës edhe nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI